

Anisa Pollo, mban pozicionin e Drejtoreshës së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Kulturës në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ku është e komanduar që nga janari i vitit 2024.

Në këtë rol, Anisa harton dhe implementon strategji të politikave kulturore, duke koordinuar me institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për të promovuar trashëgiminë dhe diversitetin kulturor. Ajo mbikëqyr gjithashtu financimin e projekteve kulturore, përfshirë menaxhimin e fondeve dhe organizimin e aktiviteteve si festivale, ekspozita dhe ngjarje të tjera që promovojnë artin dhe kulturën.

Me një arsim të lartë të plotë, duke përfshirë një Master Shkencor (MBA) nga "Canadian Institute of Technology" dhe dy Bachelor në financë, nga Universiteti European i Tiranës dhe Universiteti i Tiranës ajo ka një përvojë të pasur profesionale në sektorin publik dhe privat, me ekspertizë të theksuar në fushat e politikave kulturore, marketingut dhe menaxhimit financiar. Aktualisht,

Nga janari i vitit 2019 deri në korrik të vitit 2024, Anisa ka shërbyer si Drejtoreshë e Njesisë së Promovimit dhe Ndërgjegjësimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, ku ka krijuar dhe menaxhuar strategji të marketingut për promovimin e shërbimeve të drejtorisë. Ajo ka drejtuar ekipe profesionale të marketingut, ka bashkëpunuar me partnerë dhe ka monitoruar konkurrencën për të përmirësuar pozicionin e organizatës në tregun e transportit.

Përvoja e saj e mëparshme përfshin rolin e Koordinatorës dhe Marrëdhënies me Publikun në Bienalen e Venecias në vitin 2018, ku ka ndihmuar në koordinimin e projektit të Pavilonit Shqiptar, duke menaxhuar burimet njerëzore dhe raportet financiare, si dhe strategjinë e komunikimit publik.

Në vitin 2017-2018, ajo ka shërbyer si Administratore dhe Përgjegjëse Financiare në "Cycle Albania" shpk, ku ka qenë përgjegjëse për komunikimin me klientët dhe menaxhimin e financave të kompanisë, përfshirë përgatitjen e bilancit vjetor dhe analizimin e të dhënave financiare.

Po ashtu, në vitin 2016, ajo ka punuar si Menaxhere Brendi dhe Promovuese në kompaninë "Orbico" shpk, ku ka përgatitur dhe zbatuar strategji të shitjes dhe marketingut për marketat e kompanisë.

Ka përvojë të gjërë në sektorin publik dhe privat, ekspertizë të theksuar në fushat e politikave kulturore, marketingut dhe menaxhimit financiar.